

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

(PER VITIN FINANCIAR 2014)

“GRAND KONSTRUKSION M”

SHPK

MALLAKASTER

S&E LAZE AUDIT sh.p.k. , NUIS: L48709501U

**Adresa: 1- Lagja “ Selam Musai”, Tepelene, 2- Blv. “Gjergj Fishta”, prane Gjykates se Rrethit, Tirane
Tel/Cel: 069 21 73 995 E-mail: stoli.laze@yahoo.com**

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR.....	2
B. BILANCI KONTABEL	4
C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	6
E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA	7
F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	8-15

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

RAPORT I AUDITEVE TE PAVARUR

Asamblese se Pergjithshme

**"GRAND KONSTRUKSION M" SH.P.K.
MALLAKASTER**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkengjitur te shoqerise " GRAND KONSTRUKSION M" SH.P.K. te cilat perfshijne:

- *Bilancin kontabel te mbyllur me date 31 Dhjetor 2014,*
- *Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve,*
- *Pasqyren e flukseve te parase(CASH FLOW),*
- *Pasqyren e ndryshimeve te kapitaleve te veta,*
- *Nje permbledhje te politikave kontabel kryesore dhe shenime te tjera shpjeguese.*

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiar.

Drejtimi i Shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte e te sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe Standartet Nderkomtare te Raportimit Financiar .

Kjo pergjegjesi perfshin :

- *Hartimin ,venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare pa gabime materiale ,qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit.*
- *Per te perzgjedhur dhe aplikimin e politikave te duhura kontabel dhe berjen vleresimeve kontabel qe jane te pershtatshme per rrethana te dhena.*

➤ *Përgjegjësia e Auditorit*

Pergjegjesia jone eshte qe te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare,bazuar ne auditimin tone.

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.

Keto standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellimin qe te perfitojme siguri te aresyeshme qe pasqyrat financiare nuk kane gabime materiale.

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te marre prova auditimi per vlerat dhe paraqitjet ne pasqyrat financiare.

Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke perfshire vleresimin e riskut te egzistences se gabimeve materiale ne pasqyrat financiare ,qofte rezultat per shkak te mashtrimit ose te gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve ,auditori konsideron kontrollin e brendshem ne lidhje me pregatitjen dhe paraqitjen e drejte e me sinqiritet te pasqyrave financiare pershtatshme per rrethanat ,por jo per qelimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se parimeve kontabel te perdorura dhe arsyshmerine e vleresimeve kryesore te bera nga drejtuesit, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare .

Ne besojme se evidencat e auditimit qe kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare paraqesin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te pozicionin financiar te shoqerise " GRAND KONSTRUKSION M" SH.P.K. ne daten 31 Dhjetor 2014, te rezultatit financiar e te rrjedhjes se parave dhe ndryshimeve ne kapitalet e veta per ushtrimin e mbyllur ne kete date ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Republiken e Shqiperise.



Tepelene 25/03/2015

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Bilanci kontabël

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shënime	Viti raportues 31.12.2014	Viti paraardhës 31.12.2013
A	AKTIVET			
I	Aktive Afatshkurtera			
	Aktive monetare	3	1,935,102	2,469,628
	Derivatë dhe aktive të mbajtura për tregtim		-	-
	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	107,443,835	59,400,120
	Inventari	5	-	3,417
	Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje		-	-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	4	-	-
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		109,378,937	61,873,165
II	Aktive Afatgjata			
	Investimet financiare afatgjata	6.1	-	-
	Aktive afatgjata materiale	6.0	12,689,673	5,280,400
	Aktivet afatgjata jomateriale		-	-
	Kapital aksionar i papaguar		-	-
	Aktive të tjera afatgjata		-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		12,689,673	5,280,400
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		122,068,610	67,153,565
B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	Detyrime Afatshkurtera			
	Huamarrjet	7	-	-
	Huatë dhe parapagimet	8	106,040,904	63,123,352
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Provizionet afatshkurtra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		106,040,904	63,123,352
II	Detyrime Afatgjata			
	Huatë afatgjata	9	-	-
	Huamarrje të tjera afatgjata		-	-
	Provizionet afatgjata		-	-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		-	-
	Totali i Detyrimeve (I+II)		106,040,904	63,123,352
III	Kapitali			
	Kapitali i regjistruar (aksionar)	10	100,000	100,000
	Primi i aksionit		-	-
	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
	Rezerva statutore		-	-
	Rezerva ligjore	10	-	-
	Rezerva të tjera	10	196,511	-
	Fitimet(humbja) te pashpërndara		3,733,702	-
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11	11,997,493	3,930,213
	Totali i Kapitalit (III)		16,027,706	4,030,213
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		122,068,610	67,153,565

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
1	Shitjet neto	11	163,232,725	69,274,357
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Puna e kryer r	.		
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimi	.		
4	Materialet dhe mallrat e konsumuara	11	(139,587,831)	(63,286,462)
5	Kosto e punës	11		
	a)Pagat e personelit		(3,096,362)	(1,385,819)
	b)Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(565,937)	(231,433)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet		(1,397,820)	
7	Shpenzime të tjera		(4,470,078)	(3,740)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(149,118,028)	(64,907,454)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)	8.65%	14,114,697	4,366,903
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11	0	0
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjer		0	0
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667			
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		0	0
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		0	0
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2		0	0
14	Te ardhura dhe shpenzime te jashtezakonshme		0	0
15	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	8.65%	14,114,697	4,366,903
16	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69	12	2,117,204	436,690
17	Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	11	11,997,493	3,930,213
18	Elementët e pasqyrave të konsoliduara		0	0

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Shenime	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
<u>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</u>			
Fitimi pas tatimit		11,997,493	3,930,213
Rregullime për:		5,622,140	0
Amortizimin		1,397,820	0
Humbje nga këmbimet valutore		0	0
Të ardhura nga investimet		4,224,320	0
Shpenzime per interesa		0	0
Shpenzime te shtyra		0	0
Rritje/rënie në tepicën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivitetet		(48,043,715)	(59,400,120)
Rritje/rënie në tepicën inventarit		3,417	(3,417)
Rritje/rënie në tepicën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktivitetet		42,917,552	63,123,352
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		12,496,887	7,650,028
Interesi i paguar		0	0
Tatim mbi fitimin i paguar		0	0
<u>Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>		12,496,887	7,650,028
<u>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</u>			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		0	0
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(13,031,413)	(5,280,400)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		0	0
Interesi i arkëtuar		0	0
Dividendët e arkëtuar		0	0
<u>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese</u>		(13,031,413)	(5,280,400)
<u>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</u>			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		0	100,000
Hyrje nga huamarrje		0	0
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		0	0
Dividendët e paguar		0	0
<u>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>		0	100,000
<u>Rritja/rënia neto e mjeteve monetare</u>		(534,526)	2,469,628
<u>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</u>		2,469,628	0
<u>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</u>		1,935,102	2,469,628

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i rregjistruar(aksio nar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	100,000	-	-	-	-
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar		-	-		-
Fitimi neto për periudhën kontabël				3,930,213	3,930,213
Dividentët e paguar					-
Rritje e rezervës së kapitalit(perov. Rreziqe)	-		-		
Emetimi i kuotave(aksioneve)	-	-		-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	100,000	-	-	3,930,213	4,030,213
Pozicioni i rregulluar	-	-	196,511	(196,511)	-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-		11,997,493	11,997,493
Dividentët e paguar (zvogelim sipas akt-kontrollit DRT)	-	-		-	-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit			-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2014	100,000	-	196,511	15,731,195	16,027,706

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i " GRAND KONSTRUKSION M" SH.P.K

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Shënimet e Auditit te Pavarur për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjithshme

" GRAND KONSTRUKSION M" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri pergjegjesi te kufizuar dhe gjendet e regjistruar ne regjistrin tregtar (QKR), indentifikuar me NIPT-in L38109801T . Kapitali regjistruar aktualisht eshte 100,000 ALL dhe zotrohet nga ortaku i vetem, z/zj. Petref Saliaj me pjesmarrie 100% .

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2014 ka qene ndertimi , punimet publike e tregetia.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (ALL).

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet jane njohur sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve jane njohur kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, e jane matur me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve.Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve jane njohur në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe te ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri.Të ardhurat jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet jane njohur atehere kur ato jane siguruar prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj jane konvertuar në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj jane rivlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2014 janë
1 euro=140.14 leke dhe 1 dollar= 115.23 leke

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë janë regjistruar në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra janë regjistruar në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, janë mbajtur me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra në përgjithësi janë mbajtur në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet Afat Gjata Materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAGJM-të) janë të bazuara në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAGJM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e vlerës së mbetur për ndertesat dhe për të gjitha aktiveve afat gjata materiale. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës së mbetur dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje i inventareve është kryer me cmimet e blerjes dhe në rastet kur ka qene e aplikueshme i janë shtuar kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqitet me kostot mesatare ushtrimit.

3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjeteve monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 kanë qene si me poshte:

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Aktive monetare	3	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
(i) Arka		1,187,405	2,115,559
(ii) Banka		747,697	354,069
Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim			
(i) Derivatvët			
(ii) Aktivët e mbajtura për tregtim			
Totali 1+2		1,935,102	2,469,628

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe janë konfirmuar nga nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepërcat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të Bankës së Shqipërisë.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2014 janë deklaruar si vijon:

Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme		82,740,338	39,757,788
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		24,703,497	19,423,700
(iii) Instrumente të tjera borxhi			
(iv) Investime të tjera financiare			218,632
Totali 3		107,443,835	59,400,120

Në "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar kerkesat për tu arketuar nga klientët për shitjet e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, të cilat nuk janë arketuar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka ndërtuar inventaret kontabel për secilin klient dhe janë të rakorduar me shumën totale të paraqitur. Drejtimi mendon se të gjitha kerkesat do të arketohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

5. Inventari

Gjendjet e inventarit në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

Inventari	5	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
(i) Lëndët e para			3,417
(ii) Prodhim në proces			
(iii) Produkte të gatshme			
(iv) Mallra për rishitje			
(v) Parapagesat për furnizime			
Totali 4		-	3,417

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër perputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2014. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit përhershëm. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "mesatares së ponderuar".

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2014 është 139,587,831 ALL.

Shuma e inventarit të paraqitur në " Lëndët e para" përfaqëson stokun e lendeve të para dhe materialeve ndihmëse që përdoren nga shoqëria gjatë kryerjes së objektit të saj të vlerësuar me koston mesatare të ponderuar.

6. Aktivet Afatgjata

Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mëposhtme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2014.

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos(SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Gjendjet e AAM-ve në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajisje	Aktivet e tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve më 01.01.2014	-	-	1,003,600	4,276,800	5,280,400
	Shtesat	-	-	10,894,413	2,137,000	13,031,413
	Pakesimet	-	-	(1,003,600)	(4,276,800)	(5,280,400)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2014	-	-	10,894,413	2,137,000	13,031,413
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2014	-	-	-	-	0
	Amortizimi ushtrimit	-	-	542,460	855,360	1,397,820
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	(200,720)	(855,360)	(1,056,080)
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2014	-	-	341,740	-	341,740
						0
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2014	-	-	0	0	0
	Shtesat	-	-	0	0	0
	Pakesimet	-	-	0	0	0
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2014	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2014	0	0	1,003,600	4,276,800	5,280,400
						0
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2014	0	0	10,552,673	2,137,000	12,689,673

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale.

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Shoqeria nuk ka hua te klasifikuara si afatshkurtra.

Huamarrjet	7	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra		-	-
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		-	-
(iii) Bono të konvertueshme		-	-
Totali 2		-	-

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2014 paraqiten si vijon:

Huatë dhe parapagimet	8	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve		104,415,174	61,687,746
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve		230,709	1,207,180
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore		1,395,021	228,426
(iv) Hua të tjera			
(v) Parapagimet e arkëtuara			
Totali 3		106,040,904	63,123,352

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per çdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2014.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per tatimit ne burim per sigurimet shoqerore e shendetesore dhe t.v.sh te muajit Dhjetor 2014 .

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huatë afatgjata	9	Viti raportues 31.12.2014	Viti raportues 31.12.2013
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		-	-
(ii) Bonot e konvertueshme		-	-
Totali 1		-	-

Shoqeria nuk ka hua te klasifikuar si afatgjate gjate gjithë periudhes ushtrimore.

10. Kapitali e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc nuk ka pesuar ndryshime pervec kapitalit fillestar si emetim i Kapitalit Aksionar. Me 31.12.2014 ai eshte 100,000 ALL, i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1,000 ALL /kuota.

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Emertimi	Viti raportues 31.12.2014	Viti paraardhës 31.12.2013
Te ardhurat		
Te ardhurat nga shitja e produkteve	-	-
Te ardhurat nga kryerja e shërbimeve	163,232,725	69,274,357
Te ardhurat nga shitja e mallrave	-	-
Te ardhurat te tjera	-	-
Shuma	163,232,725	69,274,357

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja.

Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

▪ Shpenzimet e veprimtarisë kryesore

Lloji i shpenzimit	Viti raportues 31.12.2014
Mallra, Lendet e para dhe shërbimet	139,587,831
Kosto e Punes	3,662,299
Amortizimi	1,397,820
Telefoni, internet	0
Transport	0
Sponsorizime	0
Qira	0
Sigurime	0
Shpenzime bankare	42,876
Tatime, taksa dhe derdhje të ngjashme	96,505
Shpenzime të tjera rrjedhese	4,330,697
Shuma	149,118,028

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën faturuar ose shumën e pagueshme, të perbera nga Furnitura e shërbimeve nga të tjerë, telefoni, sigurime, Tatime, taksa dhe derdhje të ngjashme, komisione bankare etj.

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabel 2014 dhe 2013 janë si vijon:

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

I	FITIMI NETO PARA TATIMIT		14,114,697	4,366,903
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)		0	0
1	Amortizime tej normave fiskale		0	0
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor		0	0
3	Gjoha,penalitete,demshperblime		0	0
4	Provizione qe nuk njihen		0	0
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta		0	0
6	Te tjera		0	0
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)		-	0
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)		14,114,697	4,366,903
V	Shpenzimi i tatim fitimit-15%		2,117,205	436,690
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)		11,997,492	3,930,213

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

13. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

